



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0061628-5/24 dt. 23.09.2024

Mitrovicë

Në bazë të nenit 12 dhe 14, të Ligjit nr.03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/15, qershor 2008); të nenit 24 dhe 25, të Ligjit Nr.06/L-092, Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr.10/03, prill 2019); të nenit 29 dhe 31, të Rregullores (QRK) nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës; nenit 13 dhe 15, të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, Nr. 02/060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, si dhe në pajtim me Planin Zhvillimor Komunal dhe Planit Rregullues Urban “Qendra”. Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt. 23.09.2024 pasi shqyrtoi Propozim vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.02-463/02-0049468/24 dt.23.07.2024 Për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi company SH.P.K. duke përfshi edhe objekti për banim/afarizëm, me Rekomandim të Komitetit për politikë dhe financa Nr.02-060/01-0059372-5/24 dt. 12.09.2024, sjell këtë:

VENDIM

Për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi company SH.P.K. duke përfshi edhe objekti për banim/afarizëm

1. MIRATOHET Propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi private të Arsi company SH.P.K. duke përfshi edhe objekti për banim/afarizëm.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi Parcela Kadastrale P-71208072-03826-2, në sipërfaqe prej S=316 m² në Pronësi të Komunës së Mitrovicës së Jugut me vendndodhje “Takovska” Z.K. Mitrovicë KËMBEHET me:
Parcelën Kadastrale P-71208072-01286-3, me sipërfaqe të përgjithshme prej: S=93m², në Pronësi të private të Arsi company SH.P.K. me vendndodhje “Ul pijacni Trg” (sheshi i tregut), Z.K. Mitrovicë, sipërfaqe në të cilën po ashtu ekziston edhe objekt banimi dhe afarizmi dhe,
Pjesa nga Parcela Kadastrale P-71208072-01286-5, me sipërfaqe prej: S=38m², nga sipërfaqja të përgjithshme prej S=71m², në Pronësi të private të Arsi company SH.P.K. me vendndodhje “Ul Pijacni Trg” (Rr sheshi i tregut), Z.K. Mitrovicë, sipërfaqe në të cilën po ashtu ekziston edhe objekt banimi dhe afarizmi.
3. Prona e paluajtshme e komunës e cekur në pikën 2 (dy) të këtij vendimi këmbëhet për qëllim të përmbushjes së interesit publik zgjerimin të Rrugës “Ali Zeneli”, në kuadër të Planit Rregullues Urban “Qendra”.
4. Pronat e paluajtshme që këmbëhen, sipas pikës dy të këtij vendimi duhet të evidentohen në librat kadastral të Komunës.

5. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtorja për Planifikim dhe Urbanizëm.
6. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:
 - 6.1 Certifikatat e njësive kadastrale: P-71208072-03826-2 i dt. 24.06.2024, P-71208072-01286-3 i dt. 24.06.2024 dhe P-71208072-01286-8 i dt. 24.06.2024
 - 6.2 Kopjet e planit të njësive kadastrale: P-71208072-03826-2 e dt. 24.06.2024, P-71208072-01286-3 e dt. 24.06.2024 dhe P-71208072-01286-8 e dt. 24.06.2024
 - 6.3 Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr.02-060/01-0072246/20-3 dt. 26.11.2020 Për trajtim me prioritet të rrugëve “Ali Zeneli” dhe ”Lah Nimani”,
 - 6.4 Kërkesa për vlerësim të pronës Nr. 15-030/04-0033465/24 dt. 17.05.2024
 - 6.5 Raport Vlerësimi nga Ministria e Financave Punës dhe Transferove - Departamenti i Tatimit në Pronë Nr.202-1/2024 dt. 29.05.2024,
 - 6.6 Vërtetime se pronat nuk janë në hipotekë, barrë tatimore apo masë të sigurisë.
7. Vendimi shpallet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë



Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesueses së Kuvendit

1 x 1 MAPL

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

DGJKP

DPU